

UDHEZUES

PER APLIKIMIN DHE TARIFAT E LIDHJES SE RE APO MODIFIKIMIT TE LIDHJES EKZISTUESE NE RRJETIN ELEKTRIK TE OST

Tirane . Dhjetor 2010

Permbajtja

1 Hyrje

1.1 Qellimi

1.2 Kerkesat Ligjore

2. Perkufizimet

2.1 Terma te perkufizuar

3. Pergjegjesit e Lidhjes dhe Tarifat

4. Ceshtje te zbatimit

4.1 Trajtimi i Barabarte

4.2 Konfidencialiteti

4.3 Diskutimet Paraprake

4.4 Publikimi i Kostos

4.5 Aplikimi per Lidhje

4.6 Tarifa e Lidhjes

4.7 Marreveshja per Lidhje

4.8 Refuzimi per Lidhje

4.9 Anulimi (Perfundimi) i Lidhjes

4.10 De-energizimi

4.11 Ankesat

Shtojca 1: Formatet e Aplikimit per Lidhje

1.Hyrje

1.1Qellimi

Ky udhezues percakton menyren, formatin e aplikimit dhe tarifat perkatese, sipas te cilave paguhen **lidhjet e reja, modifikimet ose rritja e kapacitetit te lidhjeve egzistuese, ne rrjetin elektrik te OST**. Keto pagesa kryhen per qellimin e shpenzimeve qe nderlidhen me keto procese.

1.2 Kerkesat ligjore

Ky udhezues merr ne konsiderate dhe zbaton kerkesat e Ligjit per Sektorin e Energjise Elektrike Nr 9072, date 22.05.2003, me shtesat dhe ndryshimet perkatese, Kodit te Rrjetit te Transmetimit, Metodologjine e percaktimit te tarifes se sherbimit te transmetimit te percaktuar nga ERE, si dhe aktet e tjera nenligjore qe lidhen me funksionet kryesore te OST, ne perputhje me licencen e marre nga ERE.

2. Perkufizimet

Cdo perkufizim i cili nuk gjendet ne kete dokument, mund te gjendet ne ligjet perkatese te Sektorit te Energjise Elektrike, ne Kodin e Rrjetit – Kodi i Lidhjes, Rregullat e Tregut, Metodologjine e Tarifave te ERE, e tjera.

2.1 Termat e perkufizuar:

Tarifa per Aplikim (pagesa) eshte pagesa ne kohen kur aplikohet per lidhje, e cila mbulon studimin e pranueshmerise se lidhjes ne rrjetin e transmetimit dhe pergatitjen e dokumentacionit per hartimin e Marreveshjes se Lidhjes.

Perdoruesi eshte pala e interesuar dhe qe ka aplikuar ose eshte ne proces per lidhje te re, modifikim apo rritje te kapacitetit te lidhjes, ne rrjetin e OST.

Aplikim per Lidhje eshte kerkesa per lidhje nga **Perdoruesi** per lidhje te re, modifikim te lidhjes egzistuese, perfshire dhe rritjen e kapacitetit te lidhjes se vjeter, ne rrjetin e OST.

Formati i Aplikimit per Lidhje jane formate tip per lloj Centrali Gjenerues apo Ngarkese, perfshire konsumator i kualifikuar, sikurse jane paraqitur ne Shtojcen 1.

Kapaciteti i Lidhjes nenkupton fuqine e plote elektrike ne MVA te ofruar per lidhje te re ose per rritje kapaciteti te lidhjes ekzistuese.

Data e Lidhjes eshte data ne te cilen **Asetet per Lidhje** jane apo konsiderohen te jene plotesisht te lidhura ne rrjetin e OST dhe qe vete OST eshte ne gjendje te siguroje Kapacitetin per Lidhje.

Oferta per Lidhje eshte nje oferte per lidhje ne rrjetin e OST e dhene brenda 60 diteve ose 90 diteve, nga data e Aplikimit per Lidhje.

Pala Pergjegjese per Lidhje eshte pala qe mund te jete **perdoruesi** ose/dhe OST qe merr pergjegjesine per procesin e projektimit, tenderimit, ndertimit, testimit dhe leshimit ne pune te nje lidhjeje.

Asetet Direkte te Lidhjes ose Asetet Direkte jane asetet qe jane te nderlidhura drejteperdrejte me ndonje Oferte te caktuar per Lidhje.

Afati i fundit per Oferte eshte numri i diteve pas dorezimit te Aplikimit per lidhje, brenda te cilave OST duhet te beje Oferten per Lidhjen.

Tarifa per Mbikqyrje eshte tarifa per kontrollin dhe vleresimin e projektit teknik, mbikqyrjen e ndertimit, testimit dhe komisionimit te lidhjes.

Perdoruesi i Sistemit ose Perdoruesi eshte i lidhuri ne Sistemin e Transmetimit duke qene konsumator i lidhur direkt, Furnizues ne emer te konsumatorit te lidhur direkt, Shperndares ose Gjenerues.

Lidhja e Re eshte Central gjenerimi, linje transmetimi, nenstacion, te lidhur ne rrjetin e transmetimit ne piken/ nyjen lidhese, e percaktuar me MVA, ne nivelin nominal te tensionit.

Pika e lidhjes eshte Pika e lidhjes fizike te nje Perdoruesi me rrjetin e Transmetimit.

3 Pergjegjesit e Lidhjes dhe Tarifat

Tarifat per lidhje aplikohen vetem ndaj lidhjeve te reja, modifikimit ose rritjes se kapacitetit te lidhjeve egzistuese.

Perdoruesi i Sistemit merr pergjegjesine (eshte **Pala Pergjegjese per Lidhje**) per ndertimin e asetete te lidhjes (p.sh te tenderoj dhe paguaj per blerjen, ndertimin, testimin dhe venien ne pune) dhe:

- OST do te mbikqyr procesin
- Pas leshimit te sukseshem ne pune, OST do te marr pronesine e asetete te transmetimit deri ne kufirin ndares me asetet e perdoruesit, sipas percaktimeve te Kodit te Rrjetit te Transmetimit.
- OST do te ngarkoj Tarifen per Lidhje per perdoruesin, sipas percaktimit te bere ne paragrafin 4.6.

4. Ceshtjet e Zbatimit

4.1 Trajtimi i Barabarte

Ne pajtim me Rregullat e Tregut dhe Licencen e OST, te gjitha **Perdoruesit** do te trajtohen ne baza jo diskriminuese, pervec nese ka arsye te mirefillta teknike per dallime.

4.2 Konfidencialiteti

I gjitha komunikimi ndermjet nje **Perdoruesi** dhe OST eshte teresisht konfidencial. OST nuk do te diskutoj ceshtjet me palet e treta pervec nese merr leje me shkrim nga Perdoruesi.

4.3 Diskutimet Paraprake

Perdoruesit ftohen te kene diskutime fillestare me OST per lidhjet e mundeshme. Si pjese e ketyre diskutimeve, OST mund te ofroj nje vleresim paraprak dhe te perkoheshem per lidhjen. Keto diskutime preliminare nuk do te formojne ne vete nje **Aplikim te Lidhjes**, por do te jene nen nje konfidencialitet te plote.

4.4 Publikimi i Kostos

OST ne faqen e saj ne web do te publikoj vleren aktuale te Tarifes se Aplikimit dhe Tarifes per Mbikqyrje.

4.5 Aplikimi per Lidhje

Te gjitha **Aplikimet per Lidhje** do te trajtohen ne baze te parimit " **i pari vjen, i pari sherbehet** ". Nje **Perdorues** mundet t'i doreztoj OST nje **Aplikim per Lidhje** per lidhjen e ngarkeses ose gjenerimit ne rrjetin e OST, te modifikojte ose te rrise fuqine e lidhjes egzistuese. Kjo behet duke plotesuar dhe dorezuar nje **Format te Aplikimit per Lidhje** se bashku me pagesen e **Tarifes per Aplikim**, e cila mbulon studimin fillestar te projektit, administrimin dhe pergatitjen e **Marreveshjes per Lidhje**. **Aplikimi per Lidhje** do te

theksoj **Palen Pergjegjese per Lidhje**, i cili do te jete pergjegjese per procesin e projektimit, tenderimit ,ndertimit, testimi dhe venies ne pune te lidhjes.

Aplikimi formal nga nje **Perdorues** do te nenkuptoje fillimin e planit kohor te lidhjes, qe kerkon nga OST te pergjigjet me nje **Oferte per Lidhje** brenda **Afatit te fundit per Oferte** qe do te jete:

- 60 dite, kur jane mbajtur diskutime te sukseshme preliminare dhe studimet e projektit fillestar jane kryer plotesisht.
- 90 dite, kur nuk eshte kryer ndonje studim i pershtatshem i sistemit dhe kerkohen te dhena shtese nga **aplikuesi**.

OST realisht duhet te pergjigjet sa me shpejte qe eshte e mundur.

Kur **Perdoruesi** deshiron te zbatoje lidhjen ne disa faza kohore, atehere **Perdoruesi** mund:

- te vendos te zbatoj vetem fazen e pare me nje **Aplikim per Lidhje** vetem per ate faze.
- Te aplikoj formalisht per fazen e pare dhe te jape informacion per te gjitha fazat, perfshire edhe afatet kohore.
- Te aplikoj per te gjitha fazat me afatin kohor te percaktuar per realizimin e seciles faze.

Nese **Oferta per Lidhje** pranohet duhet te nenshkruhet **Marreveshja per Lidhje**.

4.6 Tarifa e Lidhjes

Tarifa e lidhjes do te formohet prej dy njesive te vecanta.

1. **Tarifa per Aplikim** (studimi i pranueshmerise se lidhjes ne rrjetin e transmetimit, pergatitja e dokumentacionit per marreveshjen e lidhjes me perdoruesin). Kjo tarife eshte fikse dhe do te paguhet ne vleften **300000 (treqintemije)** Leke, ne momentin e aplikimit per lidhje nga perdoruesi.
2. **Tarifa per Mbikqyrje** (tarifa per kontrollin dhe vleresimin e projektit teknik, mbikqyrjen e ndertimit, testimi dhe komisionimit te lidhjes). Kjo tarife do te jete variabel ne funksion te fuqise se plote te kerkuar, te deklaruar nga perdoruesi dhe do te kete vleren **50 Leke/KVA**, por ne te gjitha rastet nuk do te jete me e madhe se vlefta kufitare prej 2.5 milion (dymilioneepeseqintemije) Leke. Pagesa e kesaj tarife behet nga perdoruesi ne momentin e nenshkruimit te Marreveshjes se Lidhjes dhe eshte parakusht per fillimin e punes.

Kostoja e Aseteve te Lidhjes, qe perfshin koston e blerjes dhe ndertimit te Aseteve te Lidhjes, mbulohet nga vet perdoruesi ndersa kostoja e Perforcimit te rrjetit te transmetimit dhe Kostoja e O&M, mbulohen nga Tarifa e sherbimit te transmetimit ne perputhje me metodollogjine e tarifes se sherbimit te transmetimit, te aprovuar nga ERE.

4.7 Marreveshja per Lidhje

Ne se aplikuesit i pranohet kerkesa per lidhje, OST dhe perdoruesi duhet te nenshkruajne nje **marreveshje lidhjeje**.

Ne marreveshjen e lidhjes duhet te specifikohen kushtet e pergjithshme te lidhjes dhe cdo kusht specifik teknik dhe financiar i aplikuar ne ate lidhje, ne perputhje me Kodin e Rrjetit – Kodi i lidhjes.

Ne marreveshjen e lidhjes duhet te percaktohen gjithashtu:

1. Pergjegjesite per kontrollin dhe mirembajtjen e paisjeve
2. Pergjegjesite per operimin e paisjeve
3. Pergjegjesite per sigurine e personelit.

4.8 Refuzimi per Lidhje

OST do te refuzoje nje lidhje vetem nese ka arsye teknike per nje gje te tille, sic shkruhet ne Kodin e Rrjetit-Kodi i Lidhjes. Duke patur parasysh se **Perdoruesi** duhet te paguaj paraprkisht, nuk duhet te kete asnje arsye financiare per refuzim.

4.9 Anulimi(Perfundimi) i Lidhjes.

Kur nje Perdorues deshiron te anuloj Marreveshjen e Lidhjes, ai duhet te njoftoje OST nje vit para. OST ka te drejte te kaloje ne pronesi te saj pa pagese te gjithe asetet qe kane funksionin e transmetimit (deri ne kufirin e matjes tregetare).

4.10 De-energizimi

De-energizimi i lidhjes nuk llogaritet si anulim (perfundim) i Marreveshjes per Lidhje.

4.11 Ankesat

Cilido **Perdorues i Sistemit** ka te drejte te ankohet ne ERE per **Refuzimin per Lidhje** dhe per cdo mosmarreveshje me OST per **Oferten per Lidhje**.